



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

TË DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

Emri i NSH-së: **NSh Industria e Baterive Gjilan "IBG" ("Ndërmarrja")** emrat e mëparshëm DP Industria Baterije Gnjilane "IBG" Fi-768/89 ("Ndërmarrja")

Emri i Ndër së Re: **Ndërmarrja e Re IBG Shitorja SH.P.K** ("Ndërmarrja e Re")

Vendndodhja: Prona e cila është subjekt i këtij tenderi ndodhet në qendër të qytetit të Gjilanit.

Biznesi/Sektori: Industria e Baterive

Prodhimet: **Ndërmarrja e Re IBG Shitorja SH.P.K** në të kaluar kjo shitore ishte shfrytëzuar për shitjen e produkteve të prodhuara në fabrikën e IBG-së, siç ishin bateri të ndryshme, llamba, akumulator etj. Ndërsa aktualisht përdoret si kafiteri.

Tregu: Vendor

Konkurrenca: E papërfillshme

Punonjësit: Ndërmarrja aktualisht punëson 111 punëtorë. Asnjë punëtorë nuk do të transferohet në Ndërmarrjen e Re

Ndërtesat dhe tokat: Kjo ofertë do të ofrojë mundësi të shkëlqyeshme për të blerë shitoren me përafërsisht 39m², në bazë të vendimit të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit me lëndën AC nr. 49/2011 të datës 23/12/2011. Lokacioni i saj në qendër të qytetit të Gjilanit dhe ofron mundësi të shkëlqyer për afarizëm ekonomik.

Shënim i rëndësishëm:

Sipërfaqja e saktë do të dihet pas matjeve të parapara kadastrale.

- Detyrimet që do të barten:**
- 1) Detyrimet neto të NSh-së për TVSh, ku përjashtohen kamatat dhe gjobat, të cilat janë krijuar gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
 - 2) Detyrimet e papaguara të NSh-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
 - 3) Detyrimet e NSh-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë krijuar gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
 - 4) Kosto e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve (duke mos i përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera për ose në



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

emër të punëtorëve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punëtorë) e mbledhur gjatë rrjedhës normale të biznesit që:

- Është mbledhur gjatë periudhës tre mujore që përfundon në datën kur deklarata relevante e transferit ka hyrë në fuqi;
- Që mbetet e papaguar deri në atë datë dhe i ngarkohet biznesit të NSh-së.

**Orto-fotoja e
Ndërmarrjes së
Re**

IBG Shitorja



Informatat:

Departamenti i Shitjes

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +381 (0) 38 500 400 -1255

Fax: + 381 (0) 38 248 076

www.pak-ks.org

**Dokumentet e
Ofertimit:**

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rr. Ilir Konushevci Nr.8

10000 Pristinë, Kosovë

Rr. E Bujanovcit PN
(f-ika baterive IBG)
60 000 Gjilan, Kosovë,
Tel: 0280 328 444,
Fax: 0280 326 000
www.pak-ks.org